



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 1, datë 10.02.2026



PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE DERI NË 6% TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE SI DHE PËR ATO QË DO TË TRAJTOHEN ME FONDE TË BUXHETIT VENDOR

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 21, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kreut IV, pika 1, të Vendimit nr. 597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 3, datë 17.02.2017 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Mbi zbatimin e Vendimit nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 4, datë 17.02.2017 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për përlogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 5, datë 17.02.2017 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 përqind”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.73, datë 23.12.2026 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm 2026-2028”, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e kriterëve mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar dhe fondit të buxhetit vendor për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 përqind, si më poshtë:
 - a) Familjet në nevojë që përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda 3 (tre) muajve të fundit nëpërmjet Regjistratit Elektronik Kombëtar, për ndihmën ekonomike dhe të cilat nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit për pamjaftueshmëri pikësh.
 - b) Përfitues do të jenë aplikues që kanë paraqitur dosje të plotë dokumentacioni.
 - c) Familjet me nevoja social-ekonomike të theksuar, me prioritet si: familje me më shumë se 4 (katër) anëtarë, familje me 1 (një) anëtar dhe gratë kryefamiljare të divorcuara/të veja me fëmijë në ngarkim, familje pa të ardhura, të moshuar të vetmuar, rastet kur kryefamiljari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët janë të paaftë për të punuar, por për shkak të legjislacionit nuk përfitojnë pagesa PAK.
2. Të miratojë procedurat mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar dhe me fondet e buxhetit vendor për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 përqind, si më poshtë:
 - a) Njësitë administrative të Bashkisë Durrës përpunojnë listën e përfituesve dhe vlerësojnë dosjet për t'u trajtuar me këto fonde.
 - b) Njësitë administrative të Bashkisë Durrës dhe Njësitë Administrative dërgojnë projektvendimet çdo muaj pranë Drejtorisë së Shërbimeve Sociale Durrës, e cila harton listën e përfituesve të mundshëm.
 - c) Njësitë administrative propozojnë fondin e kushtëzuar për çdo familje, referuar Udhëzimit nr. 4, datë 17.02.2017, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale "Për përlogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike", të ndryshuar.
 - d) Njësitë administrative konfirmojnë shkresërisht çdo muaj, pas zbardhjes së vendimit për ndihmën ekonomike, listën e personave, që do të vazhdojnë të përfitojnë nga fondi i kushtëzuar dhe nga fondi i buxhetit vendor mbi bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 përqind.
 - e) Drejtoria e Shërbimeve Sociale, harton projektvendimin për familjet në nevojë, që do të trajtohen në bazë bazë të vlerësimit social-ekonomik dhe propozimeve të bëra nga njësitë administrative dhe lagjet, për trajtim me ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6 përqind.
3. Të miratojë dokumentacionin që duhet të plotësojë Administratori Social mbi aplikimin e përfitimit nga fondi i kushtëzuar dhe nga fondi i buxhetit vendor i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 përqind, si më poshtë:
 - a) Kopjen e kartës së identitetit të aplikantit dhe kopje të kartave të identitetit të anëtarëve të tjerë të familjes që kanë karta identiteti;

- b) Çertifikatën familjare që lidhet me regjistrin e familjes, për të gjithë ata persona që janë pjesë e të njëjtës gjendje familjare;
- c) Dokumenta të tjera të nevojshme, për të përcaktuar të ardhurat familjare;
- d) Vërtetimin e trajtimit në institucionet e përkujdesit shoqëror, për rastet e parashikuara;
- e) Urdhrin e mbrojtjes ose urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes, për rastet e parashikuara;
- f) Vërtetimin e gjykatës që bashkëshortët e familjes që paraqitet për të përfituar ndihmën ekonomike janë në proces zgjidhjeje martesore;
- g) Kopjen e noterizuar për statusin e jetimit, sipas kërkesave të parashikuara në Ligjin nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar;
- h) Kopjen e vërtetimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësive për Punë, për familjet që në përbërje të tyre kanë invalidë pune apo persona me aftësi të kufizuar që përfitojnë pagesë për aftësinë e kufizuar, përfshirë edhe dokumentacioniet e tjera;
- i) Çertifikatën e pronësisë, të lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, apo aktin e marrjes në pronësi ose në përdorim të tokës, për zonat ku regjistrimi i pronësisë nuk ka përfunduar ende;
- j) Vlerësimin social-ekonomik për çdo aplikues.



4. Dokumentacioni shkresor nga njësitet administrative përmban:

- a) Listën përmbledhëse emërore të përfituesve të mundshëm, sipas shtojcës nr. 4, të VKM-së 597, datë 04.09.2019, të ndryshuar;
- b) Tabela përmbledhëse mbi numrin e familjeve dhe fondin e parashikuar.

5. Masa e ndihmës ekonomike për çdo familje do të përlllogaritet sipas Udhëzimit Nr.4, datë 17.02.2017 “Për përlllogaritjen e përfitimit të Ndihmës Ekonomike”, i ndryshuar.

6. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR

Denisa Luarasi



U shpall sot me datë 11.02.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 140 prot.

Durrës, më 16.02.2026

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.01 datë 10.02.2026, "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtezuar për bllok ndihmën ekonomike si dhe për ato që do të trajtohen me fonde të buxhetit vendor".

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI
ADRIAN GURRA

